



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 242, Datë 30.09.2025

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “GSA ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2478/1 prot., datë 23.09.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GSA Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2478 prot., datë 18.09.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a” dhe “c”; si dhe për pikën 2.4, gërmat “a” dhe “b”.
- Shoqëria duhet të plotësojë më tej informacionin/dokumentacionin si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë informacion në lidhje me stafin teknik që është aktualisht efektiv në strukturën e saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të dokumentojë mbështetjen financiare për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 (një) muaji të veprimtarisë.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- **gërma “b”**: Shoqëria ka referuar dy sisteme IT, ndaj duhet të sqarojë se cilin sistem do të përdorë për realizimin e procesit të faturimit të klientëve.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të sqarojë se si parashikon disponimin e zyrave për pjesën e mbetur të periudhës së licencimit.
- **gërma “d”**: Shoqëria duhet të japë informacion mbi mënyrën e realizimit të matjes për klientët.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GSA Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GSA Energy” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI